



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shkodër, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Zj.** \_\_\_\_\_

Në përgjigje Tuajës nr. 12801, datë 14.9.2023 “Kërkesë për informacion” referuar Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë, si më poshtë vijon:

**1. Tregu në lagjen Rus:**

Bashkia Shkodër me thirrjen e AZHBR për aplikime për projekte, në kuadër të thirrjes “Skema Kombëtare” në zbatim të VKM nr. 125 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023” dhe Udhëzimit Nr. 5, datë 3.3.2023 për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, ka aplikuar përmes shkresës nr. 5110 datë 11.04.2023 pranë AZHBR me projektin “**Rikualifikim i merkatos Rus (Mbulesa e Tregut)**” bashkefinancim në vlerën 36,622,584 lekë me TVSH prej të cilave 7,466,773 mbulohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

Përmes shkresës nr. 11186 Prot. dt. 09.08.2023, “Njoftim me shkrim për miratimin e aplikimit” nga AZHBR, jemi njoftuar për shpallje fituesi dhe mbështetje në masën 29,155,811 lekë. Projekti parashikon rikualifikimin e stendave të tregut të fruta perimeve si dhe ndërtimin e mbulesës së këtij tregu. Sipas urdhër shpenzimit nr. 537 datë 30.08.2023 “Akordim Fondi” nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është transferuar fondi në vlerën 29,155,811 lekë bashkisë Shkodër. Sipas procedurave standarde të menaxhimit të buxhetit bashkia Shkodër duhet të miratojë në Këshillin Bashkiak këtë shtesë fondi.

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak datë 13.09.2023 është miratuar vendim nr.29 date 13.9.2023 per nje shtese dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodrës të miratuar me VKB nr. 71 date 27.12.2022 "Per Miratimin e Buxhetit te Bashkise Shkoder per vitin 2023 dhe programin afatmesem perfundimtar 2023 - 2025" (Rikualifikim tregu Rus), konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. prot. 12924/1 date 19.9.2023. Ky projekt është në procedurat e tenderimit.

Tregtarët aktual që shesin në tregun e Rusit në momentin e fillimit të zbatimit do të transferohen në një pronë pranë tregut për të tregtuar aty për një kohë provizore deri në përfundimin e ndërtimit të mbulesës dhe standave të reja.

### **1. Rehabilitimi i Molit Shkodër**

Rehabilitimi i molit Shkodër është një projekt i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me vlerë investimi sipas preventivit 149,943,355.15 lekë. Bashkia Shkodër është institucioni përfitues i këtij investimi e cila ka miratuar lejen ndertimit nr.5328/3 prot ,datë 10.05.2023.

### **2. Rruga Shirokë Zogaj Kufi**

Rruga Shirokë Zogaj Kufi është një projekt i zbatuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me vlerë investimi sipas preventivit 581,384,747 lekë. Bashkia Shkodër është institucioni përfitues i këtij investimi e cila ka miratuar lejen infrastrukturës nr. 24762/2 prot, datë 17.06.2022.

### **3. Aksioni për lirin e hapësirave publike**

Ne tregun "Rus" po krijohen hapësira te perkohshme dhe po sistemohen cdo dite te gjithë 27 tregtaresh ambulante qe nder vite jane lejuar te shesin ne hapesirat publike trotuare ne afersi te ketij tregu.

Bashkia Shkoder ka krijuar grupe pune mes pergjegjesve per tregjet, policise bashkiake, administratoreve te rajoneve qe po identifikojne hapësira te mundshme per ti kthyer ne tregje ne sherbim te komunitetit, njekohesisht po kryen kontrolle te vazhdueshme ne hapesirat publike. Jane ndermarre cdo muaj masa ndeshkimore nga ana e Policise Bashkiake per kete drejtim per kundervajtesit.

Problematika e mbartur gjate dhjetra viteve duke lejuar dhe mos ndeshkuar shkelesit ne drejtim te zenies se hapësirave publike ka sjelle keq edukimin e qytetareve duke u krijuar idene se zenia e hapësirave publike nuk ndeshkohet. Po punohet njekohesisht me shpjegimin e rregullave ligjore dhe morale per kete gje, njekohesisht ndeshkimin e kundervajtesve dhe po shpejtohet puna per gjetjen e hapësirave per tregje qe qytetareve te mos u mungojne tregjet per sherbime.

Duke ju falenduar.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

